

TECHNICAL DATA SHEET**BONDEX****PËRSHKRIMI**

BONDEX është produkt me baze cemento në formë pluhuri, i projektuar për ngjitjen dhe rrafshimin e pllakave të izolimit termik në fasada, xokolatura dhe sisteme termoizoluese. Kur përzihet me ujë formon një masë homogjene, në trajtë paste dhe pa kokrriza, thiksotropi të lartë dhe stabilitet në aplikim vertikal. Produkti krijon lidhje të forta me pllakat termoizoluese dhe me suportet e qëndrueshme, duke mundësuar një shtresë rrafshuese kompakte, të forcuara dhe të përshtatshme për veshje dekorative të mëvonshme.


Produkti është formuluar për të dhënë punueshmeri shumë të mirë, kapje të lartë në pllakë termoizolimi, strukture të imet të shtresës, rezistencë ndaj lageshtisë dhe stabilitet gjatë aplikimit. Këto karakteristika e bëjnë të përshtatshëm edhe për riparimin, nivelimin, forcimin e të gjitha suporteve të tjera me baze cemento ose pllakë karton – xhës, cimentato, rregullimin e supoteve të vjetra ashtu dhe ato të reja.

KARAKTERISTIKAT

1. Ngjitje dhe rrafshim i pllakave termoizoluese EPS, XPS dhe lesh guri.
2. I forcuar me fibra, me rezistencë të lartë ndaj lageshtisë.
3. Punueshmeri e mirë dhe stabilitet në aplikim vertikal.
4. I përshtatshëm për fasada, xokolatura dhe sisteme termoizoluese kapot.
5. Reakcion ndaj zjarrit: Klasa A1.
6. Ngjitje maksimale dhe lidhje e fortë me pllakat termoizoluese dhe bazamentet minerale të qëndrueshme.
7. Granulometri e imet për sipërfaqe dhe teksture të mbyllur dhe kompakte.
8. Thiksotropi e lartë: lejon aplikim vertikal pa rrjedhje të materialit dhe ndihmon në shmangien e rrëshqitjes së pllakave termoizoluese gjatë vendosjes.
9. Performancë e lartë ngjitjeje me suportet kryesore të ndërtimit si suva tradicionale, shtresa rrafshuese, mure tulle, beton dhe veshje të vjetra të qëndrueshme.
10. Ngurtësim i kontrolluar pa tkurrje të ndjeshme, kur produkti përgatitet dhe aplikohet në kushte normale pune.
11. I përshtatshëm për shtresa rrafshuese të thjeshta ose të forcuara në aplikime të brendshme dhe të jashtme mbi bazamente minerale.
12. Mundëson krijimin e një shtrese të forcuar homogjene me rrjete tekstil-xhami rezistente ndaj alkalitetit.

FUSHA E APLIKIMIT

Ngjitje dhe rrafshim i pllakave termoizoluese në sistemet e izolimit termik të jashtëm kapot. Ngjitje dhe rrafshim i pllakave EPS, XPS, PIR, shkumë fenolike, lesh mineral/lesh guri, kork, aerogel dhe panele të tjera termoizoluese të përshtatshme për ngjitje me produkt me baze cemento. Aplikim në mure dhe tavane, mbi suva, murature, beton dhe bazamente minerale të qëndrueshme. Aplikim mbi mure tulle, tulla termike, mure të perziera, mure guri, beton, suva të reja dhe suva të vjetra të lidhura mirë. Aplikim mbi shtresa ekzistuese të qëndrueshme, përfshirë suva/rrafshime tradicionale dhe veshje të vjetra të lidhura mirë, pas pastrimit dhe verifikimit teknik të ngjitjes. Rrafshim i thjeshtë ose i forcuar me rrjete tekstil-xhami për aplikime të brendshme dhe të jashtme mbi bazamente minerale. Shtresa rrafshuese mbi pllakë termoizoluese, duke krijuar sipërfaqe homogjene për veshje dekorative finale. Rrafshim i forcuar mbi panele me baze çimentoje/fiber-çimento, përfshirë panele që përdoren si veshje në fasada të ventiluara, kur sistemi është i përshtatshëm për këto aplikime. Forcimi i të gjithë llojeve të bazamenteve minerale për veshje të mëvonshme dekorative. Përdorim në fasada, xokolatura, zona bashkimi, kende dhe detaje ku kërkohej shtresa kompakte, e mbyllur dhe e forcuar.



TECHNICAL DATA SHEET

BONDEX

REKOMANDIME

Mos aplikoni mbi metal, PVC ose sipërfaqe të tjera jo absorbuese/ jo minerale pa sistem të testuar dhe pa astar të pershtatshëm.

Mos aplikoni në ambiente me lageshti të vazhdueshme ose mbi bazamente të paqendrueshme.

Mos aplikoni mbi suporte që karakterizohen nga vibrime të vazhdueshme, deformime ose levizje të medha.

Mos e perdorni në ditë me erë të fortë, shi, ngrice ose ekspozim të drejtperdrejtë intensiv ndaj diellit. Në temperatura të larta rekomandohet mbrojtja e fasades me rrjete/mbulese të pershtatshme.

Mos aplikoni mbi pllakë termoizoluese me sipërfaqe shumë të lemuar, me film, leter kraft ose veshje që pengon aderencën, pa trajtim ose verifikim paraprak.

Mos ngjiti pllakë mbi suva, bojë ose veshje të vjetra të degraduara, të plasaritura, të shkeputura ose të paqendrueshme.

Mos aplikoni mbi suva dehumidifikuese ose sisteme speciale pa konfirmim teknik të pershtatshmerisë.

Gjatë periudhave me temperatura të larta, erë ose rrezatim diellor të fortë, mbronë fasadën me skelëri dhe rrjete hijezuese.

Në rast shiu, lageshtie të lartë ose temperaturash të uleta, kohë të thatës dhe maturimit mund të zgjaten.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhur, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Për bazamente që nuk janë të qëndrueshëm është e domosdoshme vendosja e kunjave fiksuese. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë, në kushte normale temperaturash (20° C).

APLIKIMI

Per ngjitje :

Përzieni me një përzierës elektrik 6-6.5 litra ujë me Bondex në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza.

Menyra I :

Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 30 mm duke zënë rreth 45% të pllakes me ngjites me metoden me topa dhe shirita .

Menyra II

Aplikoni produktin me mallet e dhembëzuar si në panelin termoizolues ashtu dhe në suport në menyre të kryqëzuar . Ky lloj aplikimi kërkon që suporti të mos ketë disnivele të medha .

Përpara nivelimit të sipërfaqes me kollë vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunjat/m²

Per rrafshim :

Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 5 mm. Ashtu në gjëndje të freskët aplikoni rrjetën përforcuese në mënyrë që të zhytet në ngjitës. Në kënde apo në vëndet e bashkimit në dyer apo dritare është e nevojshme që të aplikohet dy herë rrjeta përforcuese. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5° C deri në 35° C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në thatje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.

TECHNICAL DATA SHEET

BONDEX

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Konsumi për rrafshim:	2-3 kg/m ²
Konsumi për ngjitje:	4-5 kg/m ²
Ngjyra:	Bardhë /Gri
Magazinimi:	Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore:	1.65 – 1.75 gr/cm ³
Uji për përzierje:	6-6.5 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	>12
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C.
Koha e pritjes për bojën:	7 ditë
Kokrrizimi:	0.7 mm
Koeficienti konduktivitetit termik ($\lambda_{10,dry}$):	0,52 W/Mk
Forca ngjitëse në beton pas 28 ditësh:	1.7 N/mm ²
Rezistenca në shtypje:	16.1 N/mm ²
Forca ngjitëse në EPS:	144 kPa
Absorbimi i ujit:	W2
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1